



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot.
_____. _____. 2018

Tiranë më,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **Shoqërinë “OES DISTRIMED” shpk**
Adresa: Bulevardi Bajram Curri, pallati “Kastrati”, Tiranë

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për Propozim**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-69176-05-16-2018/ **Loti 1** REF-69180-05-16-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Furnizim vendosje të pajisjeve mjekësore në Shërbimin ORL për inventarët e Implantit Koklear në QSUT** e ndarë në lote: **Loti 1** Furnizim vendosje Elektrobisturi bipolare me aksesore me fond limit me fond limit **1,380,000** (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**. Afati kohor për ekzekutimin e kontratës 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Public Health Sector

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“OES DISTRIMED” shpk**

K31520054N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **541,000** (pesëqind e dyzet e një mijë) **lekë pa TVSH** dhe **649,200** (gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind) **lekë me TVSH**

2. **“BIOMETRIC ALBANIA” shpk**

J61827062E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **637,000** (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë) **lekë pa TVSH** dhe **764,400** (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) **lekë me TVSH**.

3. **“FEDOS” shpk**

K01514009I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **960,000** (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH** dhe **1,152,000** (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë) **lekë me TVSH**.

4. **“BNT ELECTRONICS” shpk**

J61817047D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **577,850** (pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH** dhe **693,420** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet) **lekë me TVSH**.

5. **“MONTAL” shpk**

J62009007F

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **577,850** (pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH** dhe **693,420** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet) **lekë me TVSH**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **“BNT ELECTRONICS” shpk**

J61817047D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, administrativ dhe ekonomiko-financiar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejtë që:

Bazuar në kërkesat e DST në pikën a. të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, kërkohet Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës I; dhe kjo gjë është shprehur në specifikimet teknike të DST. Operatori ka dorëzuar një formular jo të rregullt oferte, duke mos plotësuar për të gjithë zërat e kërkuar të aksesoreve elementet e mëposhtëm:

- Përshkrimi i mallrave

- Sasia

- Çmimi Njësi

Mbështetur në sa mësipër OE nuk plotëson kriterin ekonomik tek oferta e paraqitur.

Përsa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë duke e s, kualifikuar këtë OE

2. **“MONTAL” shpk**

J62009007F

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, administrativ dhe ekonomiko-financiar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejtë që:

-Operatori ekonomik “MONTAL” shpk, nuk i plotëson kriteret, pasi tek KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT pika 2.3/g Për kapacitetin teknik në DST është kërkuar :

g) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi Certifikatën ISO 9001:2008/ ISO 9001:2015

mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, të prodhuesit / distributorit të autorizuar dhe prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

-Ndërkohë është sjellë Certifikatë ISO 13485:2012 dhe nuk është sjellë ISO 9001:2008/ ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, të prodhuesit / distributorit të autorizuar dhe prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit siç është kërkuar në DST.

Po kështu ka katalogë të pa markuar dhe pa nr. rendor.(duke u konsideruar devijim i vogël).

Përsa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë duke e s,kualifikuar këtë OE.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga **Shoqëria “OES DISTRIMED” shpk** me adrese Bulevardi Bajram Curri, pallati "Kastrati", Tiranë, përfaqësuar nga Administratorja Znj.Orjada Jaho, me një vlerë të përgjithshme prej **541,000** (pesëqind e dyzet e një mijë) **lekë pa TVSH** dhe **649,200** (gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind) **lekë me TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë** me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tirane sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **08.06.2018**

Ankesa: nuk ka patur

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enkelejdi JOTI